



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:209180  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05722858

Ac.nr.5912/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi - Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. M nga Graçanica, të cilin e përfaqëson me prokurë I. S avokat në Prishtinë kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson D. H, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, C.nr.106/2016 të datës 24.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si e bazuar, ankesa e të paditurës B..., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, C.nr.106/2016 i datës 24.11.2020, PRISHET dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet kërkesëpadia e paditësit D. M nga Graçanica dhe detyrohet e paditura B... që paditësit t'ia kompensoj dëmin material që ka pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut të ndodhur me 02.01.2013 në Graçanicë, për fitimin e humbur, për periudhën kohore nga 02.01.2013 deri me 31.10.2020, në shumën 10,399.70€ si dhe interesin e llogaritur për periudhën në fjalë prej 8% në baza mujore, në vlerë 13,353.88€. Me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga data 24.11.2020 si ditë e aktgjykimit, të gjitha këto brenda 15 ditëve nga marrja e aktgjykimit nën kërcënimin e

përmbartimit. Në pikën II., të dispozitivit e paditura B... detyrohet që paditësit D. M nga Graçanica t'ia paguaj qiranë mujore duke filluar nga data 01.11.2020 dhe në të ardhmen derisa ekzistojnë kushtet ligjore në vlerë prej 56.00€ në muaj deri me datë 5 të çdo muaji dhe nëse nuk e kryen pagesën brenda afatit të përcaktuar, detyrohet të paguaj kamatëvonesën e parashikuar nga kjo shumë, duke filluar nga data 5 i çdo muaji, deri në pagesën e çdo kësti individual, dhe të paguaj njëherit të gjitha këstet e duhura, të gjitha brenda 15 ditëve nga marrja e këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit me dhunë. Në pikën III., të dispozitivit e paditura detyrohet t'ia paguaj paditësit shumën 1,614.00€ për shpenzimet e procedurës në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovoj këtë ankesë si të bazuar, të ndryshoj aktgjykimin e atakuar, ashtu që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, apo të njëjtin ta prishe dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit:**

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi D. M ka parashtruar padi ndaj të paditurës B..., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj dëmin që ka pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut të ndodhur me 02.01.2013 në Graçanicë, për fitimin e humbur, për periudhën kohore nga 02.01.2013 deri me 31.10.2020, në shumën 10,399.70€ si dhe interesin e llogaritur për periudhën në fjalë prej 8% në baza mujore, në vlerë 13,353.88€, me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga data 24.11.2020 si ditë e aktgjykimit, të gjitha këto brenda 15 ditëve nga marrja e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: marrëveshja jashtëgjyqësore e datës 15.07.2013, e paraqitur me nr.344/13, e lidhur ndërmjet B... dhe D. M, Raporti policor i vitit 2013, skica e vendit të ngjarjes, dokumentacioni mjekësor, lista e lëshuar nga Qendra Shëndetësore e Mitrovicës nga 18.01.2013 deri me 25.01.2013, mendimi i komisionit mjekësor me nr. 2101/2013,

dokumentacioni mjekësor në emër të paditësit, raporti i ekspertit mjekësor nga specialisti i punës Xh. Sh nga 14.08.2020, raporti i ekspertit aktuar A. B nga 12.10.2020, ekstrakti nga lista pronësore nr.3 për ZK Graçanicë në emër të M.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se e paditura i ka paguar paditësit një paradhënie prej 2,000.00€. Me marrëveshje jashtëgjyqësore e paditura dhe paditësi janë pajtuar që paditësit t'i paguhet shuma prej 6,586.00€ si kompensim dhe 215€ për kompensimin e avokatit, gjithsej 6,801.00€, ndërsa për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk u pajtuan dhe kjo çështje ka mbetur e hapur. Paditësi si pasojë e aksidentit të trafikut të ndodhur me 02.01.2013 në Graçanicë, ka pësuar lëndime të rënda trupore.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: ..... c) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, nuk e miraton Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk është vërtetuar në mënyrë dhe masë të plotë gjendja faktike si dhe është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Nga procedura e zhvilluar dhe nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë shihet se gjykata e shkallës së parë, lidhur me bazën e kërkesëpadisë ka vlerësuar se paditësi D. M si pasojë e aksidentit të datës 02.01.2013 dhe zvogëlimit të aftësisë punuese, kompensimi për fitimin e humbur – rentës, e përpiluar nga eksperti financiarë për periudhën e kaluar nga data 02.01.2013 deri me 31.10.2020, është në lartësi prej 10,399.70€. Kolegji gjen se në procedurën e zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar në mënyrë të drejtë shkalla e zvogëlimit të aktivitetit të punues

që e ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit të ndodhur, nën përgjegjësinë e të sigurvearit të të paditurës. Megjithatë, kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë shumë e caktuar për kompensimin e kësaj kategorie të dëmit nuk është argumentuar në mënyrë dhe masë të plotë. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se është punuar ekspertiza financiare por nuk është caktuar baza për kompensim. Meqenëse zvogëlimi i aktivitetit punues paraqet formë të dëmit material, gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur që të vërtetoj se nëse paditësi ka punuar, ka realizuar të ardhura dhe sa ka qenë lartësia e të ardhurave. Në këtë mënyrë, së pari do të duhej që të vërtetohej baza për kompensim e më pastaj lartësia e kompensimit. Nga këto shkaqe, kolegji gjen se, qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur dhe ka marrë vendim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në ri procedurë në gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurën e serishme gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e të metave si më lartë, dhe konform udhëzimeve të dhëna të vërtetojë nëse paditësi ka punuar, ka realizuar të ardhura dhe sa ka qenë lartësia e të ardhurave. Gjykata e shkallës së parë të bëjë plotësimin e ekspertizës financiare, të nxjerrë edhe prova të tjera për të cilat vlerëson se është e nevojshme dhe varësisht nga vërtetimi i fakteve në procedurë dhe pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike e me aplikimin e drejtë të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së parë të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje kontestimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika c) të LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5912/2021 më datë 21.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj